



REPUBLIKA E SHQIPËRIE

MINISTRIA E FINANCËVE

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT**

**UDHËZIM**

*Nr 7860*

*dt 22.5/15*

**Nr 16 datë 22.05.2015**

**PËR**

**NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR.5, DATË 27.02.2014 "PËR SHLYERJEN E DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA", I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, në zbatim të nenit 38 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr 50, datë 5.2.2014 "Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit" i ndryshuar, dhe në zbatim të Vendimit Nr.15, datë 09.01.2015 dhe Vendimit Nr. 16 datë 26.02.2015 të Komitetit të Detyrimeve të Prapambetura, Ministri i Financave:

**UDHËZON**

1. Në pikën 2 të Udhëzimit Nr. 5, datë 27.02.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura", shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

Procedurat e detajuara në këtë udhëzim do të ndiqen edhe në rastet:

- a. "e detyrimeve të prapambetura për vendime gjyqësore të formës së prerë që i përkasin periudhës përpara datës 31.12.2013, por që janë dorëzuar pranë njërive të qeverisjes qendrore nga subjektet/individët/shërbimi përmbartimorë përfitues gjatë viteve 2014-2015".
  - b. "e detyrimeve të prapambetura për vendime gjyqësore të cilat kanë marrë formën e prerë pas datës 31.12.2013, por që procesi i gjykimit dhe vendimi i shkallës së parë të gjykimit është përpara datës 31 Dhjetor 2013"
2. Pas pikës 3 të Udhëzimit Nr.5, datë 27.02.2014, shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:  
*"Nëse njësitë mund të shlyejnë një pjesë të detyrimeve të prapambetura me fondet e planifikuara për vitin 2015, mund të vazhdojnë të ndjekin grafikun e pagesave sipas planifikimit, duke respektuar parimin e kohës së krijimit të detyrimit sipas natyrës së shpenzimit. Këto pagesa do të kryhen vetëm pas miratimit nga Nëpunësi i Parë Autorizues në Ministrinë e Financave."*
  3. Në pikën 28 të Udhëzimit Nr.5, datë 27.02.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura", në fund të paragrafit shtohet fjalia "Njoftimi zyrtar dërgohet nga Drejtoria e

Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave brenda 15 ditëve kalendarike nga data e dërgimit të shkresës nga Ministria e Financave”.

4. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në fletoren zyrtare.

SHKËLQIM CANI

  
MINISTËR

